



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 558 Prot.

Tiranë, më 09.04.2024

### V E N D I M

**Nr. 92, datë 09 .04. 2024**

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup>, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”<sup>2</sup>, të ndryshuar, mori në shqyrtim ankesën Nr. 224 Regj, datë 19.10.2023, paraqitur nga znj. J.S (*në vijim ankuesja*), kundër znj. E.Xh (P), Mjeke Otorino Laringologe (ORL) pranë Qendrës Shëndetësore të Specialiteteve Nr.2, Tiranë, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “*gjinisë*”, “*përgjegjësisë prindërore*”, “*pamjes së jashtme*” dhe “*aftësisë së kufizuar*”. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

### K O N S T A T O I:

#### **I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Në ankesën e depozituar pranë Komisionerit, pala ankuese parashtron se, pretendimet e saj lidhen me mjeken ORL pranë Qendrës Shëndetësore Nr.9, Tiranë, znj. E.Xh, e cila gjatë muajve janar-shkurt 2023, ka refuzuar të ekzaminojë foshnjat e saj, me argumentin se znj. S e kishte ofenduar duke e quajtur “*mamudie*”. Ankuesja deklaroi se, situata ka agravuar, kur mjekja i ka vënë në pah kufizimin e saj vizual, duke përdorur shprehje diskriminuese “*Ti me këtë surrat më quan mua mamudie, prandaj të ka lënë zoti kështu ty me këta sytë e shtrembërta*”. Ankuesja informon se ka bërë ankim në lidhje me këtë ngjarje në Portalin Shqipëria që Duam, por nuk ka marrë asnjë njoftim zyrtar.

Sipas ankuses, mjekja E.Xh, ka refuzuar të ekzaminojë fëmijët e saj, duke i kërkuar favor koleges së saj “*Të lutem bëje për hatrin tim, vizitoja fëmijët kësaj femre, se unë nuk ia prek me dorë dhe u largua duke më kërcënuar se do telefononte policinë*”. Në këtë mënyrë, fëmija e një personi me aftësi të kufizuar diskriminohet që në lindje.

<sup>1</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

<sup>2</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

Ankuesja shprehet se, në rrugë informale ka marrë vesh se ajo nuk është e para që trajtohet në këtë mënyrë nga znj. Xh.. Znj. S thekson se, Qendra Shëndetësore Nr.9, ka një staf të mrekullueshëm dhe një figurë si Elma nuk mund t'a ulë prestigjin e atij institucioni.

Ankuesja kërkon nga Komisioneri që bordi i mjekëve të marrë masa ndaj mjekes E. Xh. dhe të mos jenë më tolerantë ndaj sjelljeve të saj të pahijshme. Ankuesja kërkon gjithashtu që znj. E. Xh. t'i kërkojë falje në lidhje me këtë sjellje.

## II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma "a", të LMD, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

LMD, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, bazuar në një listë të hapur shkaqesh, duke përcaktuar në nenin 1, të tij se: "Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër."

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD, të ndryshuar, garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi ose grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash.

Ankesa e paraqitur ishte në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të LMD, të ndryshuar dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të po këtij ligji. Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të LMD, të ndryshuar, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë.

Në ankesën e depozituar, pala ankuese ka përcaktuar se znj.E.Xh, është Mjeko ORL pranë Qendrës Shëndetësore Nr. 9 Tiranë. Për rrjedhojë komunikimi fillestar me subjektet e përfshira në procedurë filloi sipas përcaktimeve fillestare të palës ankuese. Në vijim të procedurave të ndjekura, rezultoi dhe u saktësua se, znj. Xh., ushtron detyrën si Mjeko ORL, pranë Qendrës Shëndetësore të Specialiteteve Nr.2 Tiranë.

1. Me shkresën me nr.1136/1 prot., datë 25.10.2023, Komisioneri ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga znj. E.Xh, Mjeko ORL, në cilësinë e subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa dhe nga Qendra Shëndetësore Nr.9, Tiranë. Në përgjigje të kësaj kërkesë, subjektet kanë kthyer përgjigje si më poshtë:

1.1 Me shkresën e administruar pranë Komisionerit me nr.1163/2 prot, datë 02.11.2023, znj. E.Xh, ka kthyer përgjigje duke parashtruar si vijon:

Pretendimi i znj.S është i pavërtetë, pasi unë bazohem në parimet humanitare, por zbatoj edhe Kodin e Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore. Puna jonë e përditshme konsiston në zbatimin e urdhrin nr.493, datë 02.07.2019 “Për sistemin e referimit dhe tarifat e shërbimit shëndetësor publik”, i ndryshuar, si dhe sipas Kontratës Individuale të Punës me Nr.16 prot datë 06.09.2023, ndërmjet FSDKSH-Qendra Shëndetësore e Specialiteteve Nr.2 Tiranë për vitin ushtrimor 2023, neni 5 “Detyrat e mjekut”, pika 3, ku thuhet: “Të zbatohet sistemi i referimit të shërbimeve shëndetësore. Të kryejë vizita falas për banorët e siguruar, duke identifikuar nëpërmjet dokumentit të identifikimit dhe rekomandimit të Mjekut të Përgjithshëm të Familjes (në vijim MPF) dhe për banorët e pasiguruar, vizitat kryhen kundrejt zbatimit të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.”

Duke marrë shkas nga kjo shkresë, unë bëra verifikimet e mundshme, më pas për të konkretizuar ngjarjen e pretenduar sipas znj. S. Kështu pranë shërbimit të pediatrikë në zonën e mbulimit ku konkretisht fëmijët janë të kartelizuar, nuk figurojnë të jenë dhënë rekomandimet respektive për të kryer vizitat apo ekzaminimet e pretenduara. Pra, zonja dhe fëmijët e saj nuk figurojnë në hallkat përkatëse të sistemit të referimit.

Pretendimi se, nuk është rasti i parë që unë trajtoj në këtë mënyrë pacientë apo familjarë të tjerë është i pavërtetë dhe i pabazuar pasi ndaj personit tim nuk ka asnjë ankesë në lidhje me këtë pretendim. Ngelet në përgjegjësinë e zonjës S për të vërtetuar se nga e zotëron këtë informacion ndaj meje.

Në lidhje me kërkesën tuaj për kopje të dokumentacionit mjekësor që kanë marrë fëmijët Mateo dhe Alisa S, sikurse u sqarua më lart, pasi u bënë verifikimet pranë Mjekes Pediatre respektive, nuk figurojnë që këta fëmijë të jenë paraqitur dhe regjistruar për të marrë shërbim mjekësor gjatë periudhës së kërkuar.

Në përmbledhje të parashtrimeve të mia, gjithashtu më lind detyrimi im si mjekë të bëj me dije se gjatë punës tonë të vazhdueshme duke dhënë shërbim shëndetësor të specializuar, nuk kam diskriminuar asnjë kategori, por zbatoj dhe respektoj parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit dhe nuk ka patur ankesa ku të pretendohet diskriminim. Sipas statistikave unë plotësoj dhe formularët për aplikime KEMP-i për përfitime të ndihmës sociale për personat me aftësi të kufizuara sipas kategorive të përcaktuara si dhe fëmijë të cilët vuajnë nga spektri autik.

1.2 Njoftimi dhe kërkesa për informacion i është dërguar Qendrës Shëndetësore Nr.9, Tiranë (QSH Nr.9), sipas përcaktimeve të bëra nga pala ankuese. Në përgjigje të kësaj kërkesë të Komisionerit, ka kthyer përgjigje Qendra Shëndetësore e Specialiteteve Nr.2 Tiranë (QSHS), me shkresën nr.414 prot, datë 04.11.2023, duke parashtruar si vijon:

Pasi u njohëm me përmbajtjen e shkresës, si kryem verifikimet përkatëse pranë Mjekes Specialiste ORL Dr.E.Xh (P), e punësuar pranë QSH Nr.2, e cila na komunikoi se e kishte administruar dhe vet të njëjtën shkresë.

Dr.Xh. na vuri në dijeni të përgjigjes së dërguar, megjithatë duke qenë se edhe nga ana jonë kërkoni dhënie informacioni, ju bëjmë me dije se, u verifikuan të dhënat e 2 (dy) fëmijëve të znj.J.S. U verifikua se për periudhën e kërkuar nga ana juaj Dhjetor-Tetor 2023 për M. S dhe A. S nuk ishte regjistruar asnjë shërbim shëndetësor, duke kryer verifikimet që nga Mjekja e Përgjithshme e Familjes (për moshat pediatrike) Dr.Z.. C, e cila ishte mjekja e fëmijëve, e vërtetuar kjo nga sistemi i referimit. Gjithashtu, u kryen verifikime në regjistrin e Dr.E.Xh, si dhe të Mjekes tjetër ORL e turnit sipas pretendimeve të znj.S për favorin që Dr.Xh. i kishte kërkuar në lidhje me dhënien e shërbimit ndaj fëmijëve dhe as atje nuk gjetëm asnjë të dhënë që këta pacientë kanë qenë regjistruar dhe rekomanduar për t'i kryer këto ekzaminime.

U kryen verifikime verbale duke pyetur Dr.E.Xh në lidhje me situatën që znj.S pretendon të ketë ndodhur dhe Dr.Xh. nuk pranon dhe nuk fikon që një situatë e tillë të ketë ndodhur. U kryen verifikimet pranë Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave dhe nuk u gjet ankesë në lidhje me Dr.E.Xh.

2. Nëpërmjet emailit të datës 24.11.2023 ankueses iu komunikuan parashtrimet e dërguara nga znj. Xh. dhe QSHS Nr.2 Tiranë. Pala ankuese prapësoi si të pavërteta parashtrimet e znj.Xh. si dhe qëndrimin e mbajtur nga QSH. Nuk ka mundësi që fëmija i saj të rezultojë që nuk është vizituar dhe se kamerat do të vërtetonin pretendimet e saj.
3. Bazuar në nenin 33/8, të LMD, ku parashikohet: *“Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar”*, për të sqaruar të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, Komisioneri vendosi zhvillimin e një seance dëgjimore në datën 23.1.2024. Zhvillimi i seancës dëgjimore i’u njoftua palëve me shkresën nr. 65 prot., datë 11.01.2023.

Seanca dëgjimore u zhvillua në datën 23.1.2024 me pjesëmarrjen e ankueses znj. J.S, subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa znj. E.Xh, Mjeko ORL pranë QSHS Nr. 2 Tiranë dhe znj.H.Ç, në cilësinë e përfaqësues së QSHS Nr.2 Tiranë dhe QSH Nr.9 Tiranë, sipas autorizimeve nr. 35 prot datë 22.1.2024 dhe nr.39 prot datë 17.1.2024.

Gjatë seancës dëgjimore ankuesja iu qëndroi pretendimeve të bëra në ankesë. Ankuesja deklaroi se ajo është me aftësi të kufizuara në shikim dhe se diskriminimi ka ardhur si pasojë e një keqkuptimi dhe se ngjarja e pretenduar ka ndodhur në datën 07.02.2023. Ankuesja deklaroi se rekomandimin e ka patur nga doktoreshë znj. A., cila nuk është mjekja e saj, ndërsa fëmijën ia ka vizituar mjekja ORL znj. E.. Ankuesja deklaroi se ka shkuar së bashku me dy fëmijët e saj në kohën që mjekja po linte turnin. Duke prituri mjeken, ankuesja deklaroi se ka bërë një bisedë me një paciente tjetër dhe për shkak se mjekja po vonohej ka deklaruar *“sa po vonon kjo Mamudia”*. Mjekja ka qenë aty afër dhe e ka dëgjuar ankuesen duke thënë sa më sipër. Në këtë moment ka filluar debati, gjatë të cilit ankuesja pretendon se mjekja e ka ofenduar. Ankuesja shprehet se Dr. Xh., është larguar duke i lënë porosi mjekes përballë që t'i vizionte fëmijët e ankueses.

Ankuesja deklaroi se nuk disponon ndonjë dokument në lidhje me vizitën e kryer nga mjekja tjetër ORL të fëmijës së saj, si psh. recetën që është lëshuar nga mjeku për mjekimin e fëmijës. Ankuesja gjithashtu nuk pretendoi se kanë ndodhur raste të tjera të mëparshme ose të mëvonshme me znj.Xh.. Ankuesja theksoi gjatë seancës, se për shkak të orarit të punës vizitat e fëmijëve i kishte kryer pranë mjekëve të tjerë dhe jo pranë mjekes ku janë të regjistruar fëmijët dhe se kjo ishte arsyeja pse në kartelat e fëmijëve nuk rezultojnë vizita të kryera.

Gjatë seancës dëgjimore znj. Xh., deklaroi se, puna e e saj konsiston në një punë të planifikuar dhe nuk rezulton që ta ketë fëmijën në sistem. Ajo u shpreh se nuk e mban mend ankuesen, se nuk mban mend që ajo t'i ketë thënë "Mamudie", nuk e mban mend situatën dhe as fjalët e përdorura ndaj saj nga ana e ankuseses.

Gjatë seancës dëgjimore, znj. Ç, parashtrori ndër të tjera se, nga verifikimet e kryera nga të dy QSH, fëmija nuk figuron në asnjë mjek. Në lidhje me pamjet filmike, theksoi se janë pa zë dhe se nuk janë depozituar, për shkak se ata nuk kanë kapacitetet teknike për të bërë verifikimet përkatëse në lidhje me pamjet filmike

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

#### **A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm.**

Bazuar në provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës rezultoi e provuar se, ankuesja J.S, është e datëlindjes 28.9.1988 dhe banon në Tiranë. Ankuesja është person me aftësi të kufizuara në shikim, fakt ky që rezulton i provuar në bazë të librezës "*Për përfituesit e Statusit të të Verbërit*", lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror. Referuar akteve të lëshuara nga Zyra e Gjendjes Civile Njësia Administrative Nr. 7, Tiranë, ankuesja është nëna e dy fëmijëve, A.S, e datëlindjes 19.11.2020 dhe M.S, i datëlindjes 20.01.2022.

Ankuesja pretendon se, në datën 7.2.2023 ka shkuar pranë QSHS Nr. 2 Tiranë për të vizituar fëmijë e saj pranë mjekut specialist ORL. Gjatë kohës që ka qenë në pritje të mjekut për të vizituar fëmijën, ankuesja pretendon se për shkak të një komenti që ajo ka bërë me një tjetër pacientë në lidhje me mjeken, ka filluar një debat me znj. E.Xh, Mjeke ORL pranë QSHS Nr.2 Tiranë. Ankuesja deklaroi se, për shkak se mjekja që duhet të vizitonte fëmijën po vonohej ajo është shprehur "*sa po vonon kjo Mamudia*". Ankuesja pretendon se, situata ka agravuar, kur mjekja i ka vënë në pah kufizimin e saj vizual, duke përdorur shprehje diskriminuese, duke iu drejtuar me fjalët: "*Ti me këtë surrat më quan mua mamudie, prandaj të ka lënë zoti kështu ty me këta sytë e shtrembërta*". Sipas ankuseses, mjekja E.Xh, ka refuzuar të ekzaminojë fëmijët e saj, duke i kërkuar favor koleges së saj "*Të lutem bëje për hatrin tim, vizitoja fëmijët kësaj femre, se unë nuk ia prek me dorë dhe u largua duke më kërcënuar se do telefononte policinë*".

Në këto kushte, ankuesja J.S ka paraqitur pranë Komisionerit ankesën nr. 224 regj., datë 19.10.2023, në të cilën pretendon se ajo vetë dhe fëmijët e saj A. dhe M. S, janë diskriminuar nga znj.E.Xh, Mjeke ORL pranë QSHS Nr.2 Tiranë për shkak të “gjinisë”, “përgjigjësisë prindërore”, “pamjes së jashtme” dhe “aftësisë së kufizuar”.

Në bazë të nenit 3, pika 1 të LMD, diskriminimi është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.

Në Kreun IV, të LMD, parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve. LMD, në nenin 20, pika 1, përcakton se: “1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohe të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.”. Më specifikisht në pikën 2, germa “b”, të nenit 20, të LMD, parashikohet se : “2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për:... b) mundësi për të marrë ose për të përfituar nga të mirat apo shërbimet që kanë të bëjnë me shëndetin; ”

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, të cilat japin përkufizimin e diskriminimit, për të arritur në përfundimin se ankuesja është diskriminuar duhet të plotësohen njëkohësisht 3 elementë:

- Pala ankuese është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshme. Ky trajtim mund të realizohet me veprime ose mosveprime, duke dalluar, përjashtuar apo kufizuar palën ankuese për të marrë ose për të përfituar nga të mirat apo shërbimet që kanë të bëjnë me shëndetin;
- në krahasim me sesi janë trajtuar, trajtohen ose do të trajtoheshin të tjerët në një situatë të ngjashme;
- dhe arsyeja për këtë trajtim të padrejtë është një ose më shumë, nga shkaqet që gëzojnë mbrojtje nga LMD.

Sa më sipër, për të vlerësuar pretendimin për diskriminim të parashtruar nga ankuesja, në radhë të parë Komisioneri do të vlerësojë nëse ajo dhe fëmijët e saj i është nënshtruar ndonjë trajtimi të padrejtë, të pabarabartë dhe më pak të favorshëm, nga ana e znj. E.Xh, Mjeke ORL pranë Qendrës Shëndetësore të Specialiteteve Nr.2, Tiranë.

Bazuar në informacionin dhe aktet e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës rezultoi e provuar se, fëmijët e ankuses A. dhe M. S, figurojnë të regjistruar pranë QSH Nr.9 Tiranë tek Mjekja e Familjes Dr. Z. C. Referuar kartelave personale të fëmijëve A. dhe M. S të vendosura në

dispozicion nga QSH Nr.9 gjatë seancës dëgjimore, konstatohet se fëmijët nuk kanë kryer asnjë vizitë mjekësore pranë mjekes së familjes ku janë në ndjekje. Nga ana e saj ankuesja deklaroi gjatë seancës së për shkak të orarit të punës fëmijët nuk i ka vizituar kur kanë patur nevojë pranë mjekes së familjes ku janë të regjistruar, por pranë mjekëve të tjerë të QSH. Në lidhje me këtë pretendim ankuesja nuk depozitoi asnjë dokumentacion provues.

Lëvizja e pacientëve brenda sistemit shëndetësor rregullohet nga sistemi i referimit. Referimet zakonisht përcillen nga kujdesi shëndetësor parësor drejt kujdesit dytësor/terciar në formën e një kërkesë për konsulta/ekzaminime specifike/diagnoze mbi një rast ku ende nuk është bërë apo përfunduar diagnoza. Ky sistem referimi rregullohet me urdhërin nr. 493 datë 02/07/2019 “Për sistemin e referimit dhe tarifat e shërbimit shëndetësor publik” ku dhe për herë të parë është sistemi elektronik nëpërmjet të cilit bëhet ndjekja e pacientit duke filluar nga Mjeku i Familjes, i cili është pika e parë e kontaktit deri në shërbimet e specializuara sipas nevojave të pacientit<sup>3</sup>.

Referuar shkresës nr. 414 prot datë 4.11.2023, të QSHS Nr.2 Tiranë si dhe deklarimeve të bëra nga përfaqësuesja e këtij subjekti gjatë seancës dëgjimore pranë Komisionerit, në bazë të verifikimeve të realizuara nga QSH, nuk është gjetur asnjë e dhënë që fëmijët e ankueses kanë qenë të regjistruar dhe rekomanduar për të kryer ekzaminimet e pretenduara nga ankuesja, në kuadër të sistemit të referimit.

Në lidhje me administrimin e pamjeve filmike, Komisioneri thekson se, ka kaluar një kohë e gjatë nga momenti që pretendohet se ka ndodhur ngjarja e pretenduar midis ankueses dhe Dr. E.Xh më datë 7.2.2023 dhe paraqitjes së ankesës pranë Komisionerit më datë 19.10.2023 dhe për këtë arsye kanë kaluar afatet e ruajtjes së pamjeve filmike, ku në bazë të ligjit 19/2016 “Për masat shtesë të sigurisë publike”, neni 5/3<sup>4</sup>, për disa subjekte afati është deri në 2 (dy) muaj. Bazuar në pikën 2.16, të Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm nr. 633, datë 6.11.2018 “Për përcaktimin e nivelit të masave shtesë të sigurisë dhe llojin e masave që duhet të marrin subjektet në varësi të aktivitetit apo të vlerësimit të rrezikut, si dhe procedurat e njoftimit të tyre”, afati i detyruar i ruajtjes është deri në 10 ditë<sup>5</sup>.

Gjatë shqyrtimit, ankuesja nuk depozitoi asnjë dokumentacion provues në lidhje me pretendimin se ishte pajisur me rekomandim për të kryer vizitën e fëmijëve pranë mjekut specialist ORL nga një mjek tjetër dhe jo nga mjekja e familjes Dr.Zamira Caushaj apo recetën që mjekja tjetër ORL Dr. E.C, ka plotësuar, duke qënë se gjatë seancës dëgjimore ankuesja deklaroi se, mjekja që kishte

<sup>3</sup> Korniza dhe modeli i shërbimeve të integruara sociale dhe shëndetësore, 2021, dokument i përgatitur nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në konsultim të ngushtë me përfaqësuesit e zyrës së UNDP në Shqipëri : <https://www.undp.org/sites/g/files/zskgke326/files/migration/al/korniza-shqip.pdf>

<sup>4</sup> Ligji 19/2016 “Për masat shtesë të sigurisë publike”, neni 5/3 përcakton se: “Policia e Shtetit identifikon të gjitha subjektet që disponojnë dhe administrojnë sisteme të sigurisë, si kamera për regjistrim të pamjeve filmike, CCTV me rezolucion të lartë, me rreze infra të kuqe dhe që ruajnë imazhet filmike në NRV/Server deri në 2 muaj...”.

<sup>5</sup> 2.16 Qendrat spitalore universitare dhe rajonale shëndetësore, publike dhe private: a) Instalojnë sistem me kamera të tipit CCTV, me rezolucion të lartë, me rreze infra të kuqe dhe që ruajnë imazhet filmike në NVR/server jo më pak se 10 ditë, me fushëpamje në hyrje-dalje të objektit dhe në ambientet e brendshme të pritjes së pacientëve. Skema e vendosjes së kamerave miratohet nga shefi i komisariatit të policisë në territorin ku është objekti; .....

kryer vizitën mjekësore të fëmijës kishte përshkruar një recetë për trajtimin e problematikës shëndetësore të fëmijës.

Gjatë shqyrtimit nuk u konstatua asnjë e dhënë që fëmijët e ankueses kanë qenë të regjistruar dhe rekomanduar për të kryer ekzaminimet e pretenduara nga ankuesja. Gjatë shqyrtimit nuk u arrit të administrohej asnjë fakt ose provë, e cila mund të shërbente si indicie në mbështetje të pretendimeve të palës ankuese në lidhje me sjelljen e pretenduar kundër Dr. E.Xh, Mjeke ORL pranë QSHS Nr.2 Tiranë.

Bazuar në tërësinë e fakteve dhe provave të administruara, pretendimet e ankueses kundër znj. E.Xh, Mjeke ORL pranë QSHS Nr.2 Tiranë nuk rezultuan të provuara.

Për sa më lart, përfundimisht Komisioneri vlerëson se, ankuesja J.S dhe fëmijët e saj A. dhe M. S, nuk i janë nënshtruar një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë nga ana e znj. E.Xh, Mjeke ORL pranë Qendrës Shëndetësore të Specialiteteve Nr.2, Tiranë. Në mungesë të trajtimit të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë, Komisioneri arrin në përfundimin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese dhe shkelje të dispozitave të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar nga ana e subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa.

#### **PËR KËTO ARSYE :**

Bazuar në nenin 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

#### **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të ankueses J.S dhe fëmijëve të saj A. S dhe M. S nga ana e znj. E.Xh, Mjeke Otorino Laringologe (ORL) pranë Qendrës Shëndetësore të Specialiteteve Nr.2, Tiranë, për shkaqet e pretenduara prej saj “*gjinia*”, “*përgjegjësia prindërore*”, “*pamja e jashtme*” dhe “*aftësia e kufizuar*”.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONER**

**Robert GAJDA**

Shkaku: “*gjinia*”, “*përgjegjësia prindërore*”, “*pamja e jashtme*” dhe “*aftësia e kufizuar*”.



Fusha: Të mira dhe shërbime  
Lloji i vendimit: Mosdiskriminim